



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Data	30.01.23	Vendi	KAÇANIK
Uj. org.	Numri	Shtojcë	
01	104/02-2002	✓	

Procesverbal nga Takimi Publik me temë : Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave.

Data 19.12.2022

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal
Ora:13:00

Takimin fillimisht e hapi drejtori për Shërbime Publike dhe Emergjencë Ramadush Osmani, ndërsa prezantoi edhe Kryetari i Komunës Besim Ilazi dhe Nënkyetari Sabedin Vishi.

Ramadush Osmani- drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave:

Komuna e Kaçanikut përmes Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, duke u bazuar në ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, dhe nenin 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, organizoi sot konsultimin publik me temën: Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave. Plani i deritashëm ka pasur për objektiv rritjen e mbulueshmërisë dhe pajisjen e Kompanisë “ Pastërtia” me makineri të reja- objektiva këto tashmë të arritura, me Planin e ri për Menaxhimin e Mbeturinave objektiv kryesor është zvogëlimi i mbeturinave në burim.

Ibrahim Dallosi- Përfaqësues i Lokalitetit Doganaj

Kam mëdyshje tek klasifikimi i mbeturinave, vlerësimi në peshë, mund të ketë ndikim tek pagesa, sepse shumë qytetar duke u munduar që të bëjnë më pak kilogram mund edhe ti hedhin mbeturinat vend e pa vend e të mos i fusin në kontejner.

Fadil Vishi- Përfaqësues i Lokalitetit Dubravë

Jemi të kënaqur me shërbimin e mbledhjes së mbeturinave dhe makinerinë që përdoret. Por kam dyshimet e mia edhe unë sa i përket asaj që më vonë të paguhet sasia e mbeturinave e jo

pagesa fikse. Kjo për arsye se shumë qytetar mund ti ikin pagesës, duke deklaruar më pak kg se sa në realitet kanë.

Gjatë këtij takimi publik drejtori Ramadush Osmani iu përgjigj dy p[pyetjeve të bëra në këtë debat, duke shtuar se futja e tarifës volumerike inkurajon gjeneruesin e mbeturinës që të bëjë ndarjen në burim, ngase do të paguaj vetëm për peshën që ka në kontejnerin familjar, kurse mbeturinën e ndarë mund ta kompostoj nëse është organike, po ta deponoj mbeturinën nëse është qelq, letër ose metal si dhe të përfitoj nga kompania e kontraktuar për grumbullimin e kësaj kategorie të mbeturinave.

Procesmbajtëse:

Fatlume Guri Selimi



Zyrtare Përgjegjëse për Konsultime Publike